



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 98/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Sh... Sh.p.k., me numër unik identifikues ....., me seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokatura “...” Sh.p.k., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit nr. 6878 të datës 26.06.2019, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 29.09.2022 në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar paditësit, me datë 07.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh... Sh.p.k.
- II. ANULOHET Vendimi nr. 6878 i datës 26.06.2019 i të paditurit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si i kundërligjshëm.
- III. MBETEN NË FUQI vendimi nr. 4790 i datës 12.10.2015 dhe vendimi nr. 4791 i datës 12.10.2015 të lëshuara nga Ministria e Infrastrukturës.
- IV. Ky Aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Sh... Sh.p.k., ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit nr. 6878 të datës 26.06.2019 të nxjerrë nga i padituri Ministria e Infrastrukturës, si dhe ka kërkuar që të mbeten në fuqi vendimet nr. 4790 dhe 4791 të datës 12.10.2015 për dhënien e pëlqimeve për kyçje në rrugë, me arsyetimin se i padituri në procedurë administrative nuk e ka bërë të qartë se në cilat veprime ka konsistuar shkelja ligjore e paditësit që pastaj kanë rezultuar me vendimin për ndërprerjen e punimeve. Gjithashtu paditësi ka theksuar se i padituri ka zbatuar gabimisht dispozitat ligjore pasi që vendimin e ka marrë sipas Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 (MI) por që ky udhëzim administrativ nuk ka qenë në fuqi në kohën kur është krijuar

marrëdhënia juridike në mes të organit shtetërorë (Ministrisë së Infrastrukturës) dhe subjektit në procedurë, por në këtë kohë ka qenë në fuqi Udhëzimi Administrativ nr. 09/2015 (MI), për çfarë paditësi pretendon se është shkelur parimi i sigurisë juridike i sanksionuar me nenin 29.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndërlidhur me këtë, paditësi ka theksuar se zbatimi i UA nr. 08/2017 nga i padituri ka rezultuar në vendim të kundërligjshëm pasi që ky UA ka përcaktuar afatin e përfundimit të punimeve brenda 12 muajve, ndërsa UA nr. 09/2015 ka përcaktuar se poseduesi i pëlqimit duhet të filloj ndërtimin e kyçjes në afat prej 2 viteve nga dita e marrjes së pëlqimit. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar në tërësi pranë padisë dhe ka shtuar se UA nr. 09/2015 i cili duhet të aplikohet në këtë rast, nuk ka përcaktuar afat për përfundimin e punimeve por vetëm afat për fillimin e punimeve, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit dhe që aktgjykimi i gjykatës të zëvendësoj aktin administrativ të kundërligjshëm.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurit, Avokatura Shtetërore me datë 24.12.2021 ka pranuar Aktvendimin A.nr. 1610/19 të datës 13.12.2021 për përgjigje në padi, por nuk ka paraqitur përgjigje në padi. Gjithashtu i padituri nuk ka prezantuar në seancën e caktuar për datën 29.09.2022, andaj gjykata e ka mbajtur seancën në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të paditurit pasi që i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim nr. 6878 i datës 26.06.2019 i MI; Certifikatë e pronës dhe kopja e planit për njësinë kadastrale nr. 2345, Z.K. Kievë, Malishevë; Certifikatë e pronës dhe kopja e planit; Kopja e planit për njësinë kadastrale nr. 2344, Z.K. Kievë, Malishevë; Vendim nr. 4791/15 i datës 12.10.2015; Vendim nr. 4790/15 i datës 12.10.2015; Vendim mbi eliminim e parregullsive i datës 06.10.2017; Procesverbal nr.009994 i datës 06.10.2017; Kontratë për shfrytëzimin e brezit rrugor e lidhur mes MI dhe B.G e datës 27.09.2018; Kontratë për shfrytëzimin e brezit rrugor e lidhur mes MI dhe Bashkim Gashi e datës 25.11.2015; Fletëpagesë nr. 003814; Dëshmi pagese e datës 05.04.2019; Fletëpagesë nr. 003812; Dëshmi pagese e datës 05.04.2019; Vendim për ndërprerjen e punimeve nr. 3585 i datës 04.04.2019; Procesverbal nr. 1327 i datës 04.04.2019; Procesverbal nr. 1328 i datës 04.04.2019; Vendim për ndërprerjen e punimeve nr. 3584 i datës 04.04.2019; Procesverbal nr. 02125 i datës 04.04.2019; Procesverbal nr. 01326 i datës 04.04.2019; Ankesë e datës 26.04.2019; Parashtrere e datës 30.05.2019.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 par.1 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të

përfaqësuesit të paditësit në seancë, thëniet në padi si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konstatoi se Inspektorati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, fillimisht me datë 04.04.2019 kishte nxjerrë Vendimin nr. 3585 të datës 04.04.2019 për ndërprerjen e punimeve në brezin rrugorë në rrugën nacionale N9, për shkak se vendimi nr. 4791/2015 i datës 12.10.2015 nuk është valid. Gjithashtu Inspektorati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit kishte nxjerrë Vendimin nr. 3584 të datës 04.04.2019 për ndërprerjen e punimeve në brezin rrugorë në rrugën nacionale N9, për shkak se vendimi nr. 4790/2015 i datës 12.10.2015 nuk është valid. Kundër këtyre dy vendimeve, paditësi me datë 26.04.2019 kishte parashtruar ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit.

I padituri me Vendimin nr. 6878 të datës 26.06.2019 kishte refuzuar ankesën nr. 06.4447 të datës 26.04.2019 me arsyetimin se në bazë të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ (MI) nr. 08/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MI) nr. 09/2015 për Kycje, Instalime nëpër tokën rrugore dhe për shfrytëzim të tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale, këtu paditësi ka qenë i obliguar që të ndërtoj kycje brenda afatit ligjor prej 12 muajve nga dita e marrjes së pëlqimit.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ushtron padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”* dhe në kuptim të nenit 41 par. 1 i cili përcakton: *“Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës”*

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga provat Certifikatat e pronës dhe kopjet e planit për njësitë kadastrale nr. 2345 dhe nr. 2344, Z.K. Kievë, Malishevë, gjykata konstatoi se të njëjtat janë në pronësi Sh... Sh.p.k.

Nga prova Vendim nr. 4791/15 i datës 12.10.2015 gjykata konstatoi se Ministria e Infrastrukturës duke vepruar në bazë të kërkesës së B.G të datës 28.09.2015, në pikën I të vendimit ka dhënë pëlqim për kycjen në rrugën Nacionale N9, drejtimi Pejë – Prishtinë, ana e majtë, nga ngastrat kadastrale nr. 514-4, 514-3, 513-1 dhe 513-2 për ndërtimin e pikës së

karburantit dhe në pikën II të vendimit ka përcaktuar kushtet nën të cilat ipet pëlqimi, por pa përcaktuar afat për fillimin e punimeve apo për përfundimin e punimeve, të gjitha këto në përputhje me UA nr. 2/2014 (MI) për dhënien e pëlqimit për kyçje, instalime dhe shfrytëzim të tokës në rrugë nacionale dhe rajonale.

Nga prova Vendim nr. 4790/15 i datës 12.10.2015 gjykata konstatoi se Ministria e Infrastrukturës duke vepruar në bazë të kërkesës së B.G të datës 28.09.2015, në pikën I të vendimit ka dhënë pëlqim për kyçjen në rrugën Nacionale N9, drejtimi Prishtinë – Pejë, ana e djathtë, nga ngastrat kadastrale nr. 514-4, 514-3, 513-1 dhe 513-2 për ndërtimin e pikës së karburantit dhe në pikën II të vendimit ka përcaktuar kushtet nën të cilat ipet pëlqimi, por pa përcaktuar afat për fillimin e punimeve apo për përfundimin e punimeve, të gjitha këto në përputhje me UA nr. 2/2014 (MI) për dhënien e pëlqimit për kyçje, instalime dhe shfrytëzim të tokës në rrugë nacionale dhe rajonale.

Nga provat Procesverbal nr.009994 i datës 06.10.2017 dhe Vendim mbi eliminim e parregullsive i datës 06.10.2017 gjykata konstatoi se Inspektorati i Ministrisë së Infrastrukturës me datë 06.10.2017 ka bërë inspektimin në vend punishten e ndërtimit të pikave të karburantit nga Sh... dhe ka bërë konstatimin se kompania ka filluar ndërtimin e dy pikave të karburantit në të dy anët e rrugës dhe gjatë inspektimit nuk është bërë prezantimi i dokumenteve, për çfarë është nxjerrë vendimi mbi eliminimin e parregullsive ashtu që e ka obliguar paditësin që ti dorëzojë dokumentacionin lidhur me pëlqimin për qasje në rrugë.

Nga prova Kontratë për shfrytëzimin e brezit rrugor e lidhur mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Bashkim Gashi e datës 25.11.2015, gjykata ka konstatuar se palët kanë lidhur kontratë për shfrytëzimin e brezit rrugorë sipas vendimit 4791 të datës 12.10.2015.

Nga provat Kontratë për shfrytëzimin e brezit rrugor e lidhur mes MI dhe B.G e datës 27.09.2018 gjykata ka konstatuar se palët ka lidhur kontratë për shfrytëzimin e brezit rrugorë sipas vendimit 4790 të datës 12.10.2015. Po ashtu gjykata ka konstatuar se në nenin 3 të kësaj kontrate është përcaktuar se *“me shfuqizimin e akteve nënligjore apo plotësim ndryshimet lidhur me tarifat për kompensimin e shfrytëzimit të brezit rrugor të rrugëve nacionale dhe rajonale, do të vlejnjë dispozitat e Udhëzimit Administrativ të ri në fuqi.”*

Nga provat Fletëpagesë nr. 003814, Dëshmi pagese e datës 05.04.2019, Fletëpagesë nr. 003812 dhe Dëshmi pagese e datës 05.04.2019 gjykata konstatoi se paditësi ka bërë pagesën e shumës sipas fletëpagesës për shfrytëzimin e brezit rrugorë.

Nga prova Procesverbal nr. 1327-1328 i datës 04.04.2019, gjykata konstatoi se Inspektorati i Ministrisë së Infrastrukturës ka bërë inspektim me datë 01.04.2019 në pikën e karburantit "Sh..." Sh.p.k., sipas vendimit nr. 4791/2015 të datës 12.10.2015 dhe të njëjtit kanë konstatuar si në vijim: *"... pasi kemi bërë shqyrtimin e Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 09/2015 për kyçje, instalime nëpër tokën rrugore dhe për shfrytëzim të tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale, kemi konstatuar se objektit afarist i shfuqizohet vendimi i pëlqimit nr. 4791 i datës 12.10.2015 pasi që subjekti i lartëshënuar nuk ka përfunduar ndërtimin e kyçjes në afatin prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga dita e marrjes së pëlqimit, siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 09/2015 për kyçje, neni 9."*

Nga prova Procesverbal nr. 02125 - 1326 i datës 04.04.2019, gjykata konstatoi se Inspektorati i Ministrisë së Infrastrukturës ka bërë inspektim me datë 01.04.2019 në pikën e karburantit "Sh..." Sh.p.k., sipas vendimit nr. 4790/2015 të datës 12.10.2015 dhe të njëjtit kanë konstatuar si në vijim: *"... pasi kemi bërë shqyrtimin e Udhëzimit Administrativ nr. 08/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e UA nr. 09/2015 për kyçje, instalime nëpër tokën rrugore dhe për shfrytëzim të tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale, kemi konstatuar se objektit afarist i shfuqizohet vendimi i pëlqimit nr. 4790 i datës 12.10.2015 pasi që subjekti i lartëshënuar nuk ka përfunduar ndërtimin e kyçjes në afatin prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga dita e marrjes së pëlqimit, siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nr. 08/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kyçje, neni 9."*

Gjykata i vlerësoi si të bazuara pretendimet e paditësit sepse vendimi kontestues i të paditurit nuk është në përputhje me nenin 4 par.1 dhe nenin 48 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që ky vendim është mbështetur në dispozita ligjore të cilat nuk kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të drejtave dhe detyrimeve në mes të paditësit dhe të paditurit.

Neni 4 në par. 1 i LPPA-së përcakton se: *"Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca."*

Neni 48 i LPPA-së përcakton se: *"1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga"*

*pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.”*

Ndërlidhur me pretendimet e paraqitura më lartë dhe gjendjen faktike të konstatuar, gjykata vlerëson se paditësi të drejtën e tij për qasje në rrugë e ka fituar me Vendimet nr. 4790/2015 dhe 4791/2015 të datës 12.10.2015. Këto vendime janë lëshuar në kohën ku ka qenë në fuqi UA (MI) nr. 2/2014 për dhënien e pëlqimit për kyçje, instalime dhe shfrytëzim të tokës në rrugë nacionale dhe rajonale, andaj lidhur me të drejtat dhe detyrimet e paditësit që rrjedhin nga këto dy vendime, duhet të aplikohet UA (MI) nr. 2/2014 si udhëzim administrativ në fuqi në kohën e krijimit të drejtave dhe detyrimeve në mes të paditësit dhe të paditurit.

Udhëzimi Administrativ (MI) nr. 2/2014 për dhënien e pëlqimit për kyçje, instalime dhe shfrytëzim të tokës në rrugë nacionale dhe rajonale (më tutje referuar si UA (MI) nr. 2/2014) ka hyrë në fuqi me datë 04.07.2014 dhe është shfuqizuar deri me datë 04.01.2016 kur ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ (MI) nr. 09/2015 për kyçje, instalime nëpër tokën rrugore dhe për shfrytëzim të tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale (më tutje referuar si UA (MI) nr. 09/2015), e pastaj me datë 18.05.2017 është ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MI) nr. 08/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MI) nr. 09/2015 për kyçje, instalime nëpër tokën rrugore dhe për shfrytëzim të tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale (më tutje referuar si UA (MI) nr. 08/2017).

Gjykata vlerëson se zbatimi i UA (MI) nr. 08/2017 për ndryshimin dhe plotësimin UA (MI) nr. 09/2015 nga ana e të paditurit, vetëm për faktin se në kohën kur është bërë inspektimi ky UA ka qenë në fuqi, është në kundërshtim me nenin 48 par.1, pika 1.4 të LPPA si dhe në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë së procedurës administrative, ashtu që në këtë rast ka mundur të zbatohet vetëm UA (MI) nr. 2/2014 që ka qenë në fuqi në kohën e lëshimit të vendimeve – pëlqimeve për kyçje në rrugën nacionale N9.

Gjykata konstaton se me UA (MI) nr. 2/2014, nuk është përcaktuar asnjë afat për nisjen apo përfundimin e punimeve sipas pëlqimit për kyçje në rrugë, por me UA (MI) nr. 09/2015, në nenin 13 par.7 është përcaktuar se: *“Nëse poseduesi i pëlqimit nuk fillon ndërtimin e kyçjes në afatin prej 2 vite nga dita e marrjes së pëlqimit, konsiderohet se ka hequr dorë nga kyçja dhe pëlqimi shfuqizohet me automatizëm, e njëjta vlen edhe për vendosjen e instalimeve”*, ndërsa me UA (MI) nr. 08/2017 në nenin 9 është ndryshuar par. 7 i nenit 13 të UA (MI) nr. 09/2015 dhe është përcaktuar: *“Nëse poseduesi i pëlqimit nuk përfundon ndërtimin e kyçjes në afatin*

*prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga dita e marrjes së pëlqimit, konsiderohet se ka hequr dorë nga kyçja dhe pëlqimi shfuqizohet me automatizëm.”*

Andaj, gjykata vlerëson se i padituri gabimisht ka zbatuar afatin prej 12 muajve për përfundimin e punimeve ashtu siç është përcaktuar në nenin 9 të UA (MI) nr. 08/2017, pasi që në rastin konkret, vendimet – pëlqimet janë nxjerrë në kohën kur për fillimin apo përfundimin e punimeve nuk ka pasur afat të përcaktuar. Gjykata po ashtu vlerëson se obligimet që dalin nga UA (MI) nr. 09/2015 dhe UA (MI) nr. 08/2017 nuk mund të kenë efekt prapa veprues për vendimet të cilat janë lëshuar gjatë kohë sa ka qenë në fuqi UA (MI) nr. 2/2014, ashtu që as paditësi nuk mund të ngarkohet me këtë detyrim të ri për fillimin apo përfundimin e punimeve brenda një afati të caktuar, por mund të ngarkohet vetëm me detyrimet që rrjedhin nga UA (MI) nr. 2/2014 dhe pika II e vendimeve nr. 4790 dhe 4791 të datës 10.10.2015.

Me rastin e vlerësimit të Kontratës për shfrytëzimin e brezit rrugor e lidhur mes MI dhe B.G e datës 27.09.2018 sipas vendimit nr. 4790 të datës 10.10.2015, gjykata konstaton se në kontratë është përcaktuar zbatimi i detyrimeve shtesë me rastin e shfuqizimit të akteve nënligjore apo plotësimin e tyre vetëm sa i përket tarifave për kompensimin e shfrytëzimit të brezit rrugorë të rrugëve nacionale dhe rajonale, por nuk është përcaktuar asgjë për detyrimet tjera.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me vendimin e kontestuar nga paditësi, ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 dhe 48 të LPPA-së si dhe në kundërshtim me UA (MI) nr. 2/2014, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi mbështetur në nenin 46 par. 2 të LKA-së, ndërsa për pikën II, III dhe IV vendosi mbështetur në nenin 12 dhe 46 par. 3 dhe 4 të LKA-së. Lidhur me pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi në përputhje me nenin 63 të LKA-së.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.98/22, datë 07.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerçiale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.